



Data 16.08.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE  
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përfshirë publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Blerje Gazoili për nevojat e NPP dhe Bordit të Ujitjes dhe Kullimit”**

**Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Naftë 09134000-7 Benzinë 09132000-3**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **35,333,333 (tridhjetë e pesë milionë e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) LEKË PA TVSH.**

**16,583,333(gjashtëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) LEKË PA TVSH** vënë në dispozicion nga Buxheti i shtetit.

**18,750,000(tetëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) LEKË PA TVSH** vënë në dispozicion nga Vetëfinancim.

Vlera e fondit limit është përcaktuar nëpërmjet kronometrit të normave të harxhimit të karburantit përfshirë mjetet e Ndërmarrjes, mjetet e Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit dhe makinave teknologjike (të pastrimit të mbetjeve) përfshirë vitin 2024, të cilat janë të pasqyruara në procesverbalet përkatëse, 3 ofertave të marra nga grupi i punës ku përcaktohet marzhi i fitimit dhe të 5 (pesë) Buletineve të fundit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve përfshirë kualifikim përfshirë procedurën e sipërcituar, me përmrbajtjen si më poshtë:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. . *Formularin Përbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari permbladhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", te Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe ne mbeshtetje te Nenit 26 "Formulari përbledhës i vetëdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP "1. *Bashke me dorezimin e kerkeseve per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbladhës te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",

### 1.2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilesisë) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë
- EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njojur nga Republika e Shqipërisë

*Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërise.*

*Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik".*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Kopje te deklaratave te xhiros vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres se parashikuar te kontrates.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" në të cilin gjejmë te përcaktuar se: "*Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*"; , si dhe pikat 1,2 pika c) ,3 te nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara, se zoterojne kapacetet ekonomike dhe financiare per te permbosehur kontraten sic eshte parashikuar nga AK. Përcaktimi i viteve të kërkuar për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,. Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërmë (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

**2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të **balanceve** të 3 (tre ) viteve të fundit financiare (2021 2022,2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave dhe të konfirmuara nga ky Autoritet. (Kjo kërkësë do të konsiderohet e përbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, *"Gjithashtu Autoritetet ose Entet Kontraktore mund te kerkojne qe Operatoret ekonomik te jepin informacione ne Bilancet e tyre vjetore qe te tregojne raportet ndermjet aktivit dhe pasivit"*

LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkua të për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontraten e nenshkruar, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkësave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkësave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi ose licencat përkatëse **për tregtimin me pakicë të karburanteve**, gazit të lëng-shëm të naftës, **për automjetet**, vajrave

lubrifikant dhe nenprodukteve te saj ose autorizim per tregtim karburantesh të llojit III/A (Gazoil, Diesel 10ppm) ne perputhje me Ligjin Nr. 8450 dt. 24.02.1999 « Per perpunimin, transportin dhe tregtimit te gazoil D1, benzines, gazit dhe nenprodukteve te tyre » (me ndryshimet perkatese)sipas standardeve te miratuara konformligjt.

*Argumentim: Kërkesa për këtë lloj licence të tregtimit me pakice të karburanteve, behet me qëllim të sigurimit të një pjesëmarrje sa më të gjerë të OE.*

*Pika 3 eshte vendosur ne perputhje me ligjin Nr.8450, date 24.02.1999 “Per perpunimin, transportin, dhe tregtimin e gazoil D1, benzines, gazit dhe nenprodukteve te tyre” neni 10, 19, 20(i ndryshuar me Akit Nomativ Nr. 5, datë 12.3.2022) si dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 40 pika 5/“a”.*

3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese:

- a. Flete analize ose raport analize i cilesise se diesel 10 ppm ULSD leshuar nga organet kompetente, e leshuar jo me pare se 12 muaj nga data e hapjes se tenderit.
- b. Vertetimin teknik nga Organet e **Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit**. per respektimin e normave teknike te karburantit.

*Argumentimi: Bazuar në VKM nr. 491, datë 19.07.2017 “Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nenprodukteve të tyre”.*

3.2. Operatori ekonomik duhet te siguroje furnizim te panderprere 24 ore,ne 7 dite te javes,ne qytetin ku ndodhet Autoriteti Kontraktor si dhe ne te gjitha stacionet e shitjes se karburanteve me pakice me pistoletë publike (ku ai ushtron veprimtarine).

*Argumentimi: Pika 3.2 eshte vendosur ne perputhje me Ligjin Nr.8450, date 24.02.1999 “Per perpunimin, transportin, dhe tregtimin e gazoil D1, benzines, gazit dhe nenprodukteve te tyre”(i ndryshuar me Akit Nomativ Nr. 5, datë 12.3.2022), ne Ligjin nr.162 datë 23.12. 2020“Për Prokurimin Publik” neni 77 pika 1/”c”.*

*Specifikimet jane marre nga Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit.*

3.3. Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qera te provuar me dokument ligjor(Ekstrakti tregtar i QKR-se i shoqueruar me dokument pronesie ose kontrate qeraje) se paku ne pike furnizimi brenda territorit te Qytetit Lushnje me afat vlefshmerie per te gjithe afatin e zbatimit te kontrates per kete objekt prokurimi.

*Argumentimi:*

*Pika 3.3 eshte vendosur ne perputhje me Ligjin Nr.8450, date 24.02.1999 “Per perpunimin, transportin, dhe tregtimin e gazoil D1, benzines, gazit dhe nenprodukteve te tyre”(i ndryshuar me Aktit Nomativ Nr. 5, datë 12.3.2022).*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet te dorëzoje përparrë publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit te percaktuar ne kerkesen per dorezim dokumentacioni prane AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 te VKM-se 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme përfunksionet e kërkuar, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tillë duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Njësia e Prokurimit:**